



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 785

Prishtinë, Dt. 06/05/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI
Projektpropozimi	"Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit" (Land use potential for sustainable planning in the municipality of Gjilan)
Kandidati	Edon SHEMSEDINI
Mentori	Prof. Asoc. Ferim GASHI
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 29.07.2023 Vendimi nr.: 2693
Vlerësimi i dorëshkrimit Kandidati Edon SHEMSEDINI ka paraqitë kërkesën për vlerësim të dorëshkrimit në punimin e temës së diplomës-master, me titull " Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit ((Land use potential for sustainable planning in the municipality of Gjilan)) " Tema është nga fusha e planifikimit të hapësinor, prandaj paraqet fushë interesi për shkencën dhe shoqërinë, me qëllim që ky territor të jetë sa më funksional, atraktiv dhe i qëndrueshëm për banorët e kësaj komune. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë potencialin e përdorimit të tokës në komunën e Gjilanit, me fokus në kuptimin dhe analizimin e llojeve të përdorimit të tokës, mbulueshmërisë së tyre, dhe mundësive për zhvillimin e këtyre llojeve, duke përdorur metoda të ndryshme gjeografike, përfshirë Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), Remote Sensing dhe Planifikimin Hapësinor. Qëllimi i studimit për temën "Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit" është të vlerësohet dhe analizohet përdorimi i tokës në këtë komunë, duke u përqëndruar në disa aspekte kyçe që lidhen me mënyrat më efektive dhe të qëndrueshme për menaxhimin dhe zhvillimin e saj. Ky studim ka për qëllim: <ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi i qëndrueshëm: Analizimin e përdorimit aktual të tokës dhe ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë periudhës kohore, si dhe propozimin e strategjive për përdorimin e	

qëndrueshëm të saj, me një fokus të veçantë në ruajtjen e mjedisit.

- **Planifikimi urban dhe rural:** Shqyrtimin e planifikimit aktual urban dhe rural, si dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin dhe optimizimin e përdorimit të tokës, në përputhje me nevojat e komunitetit dhe perspektivat e zhvillimit të ardhshëm.
- **Identifikimi i potencialit ekonomik:** Vlerësimin e mundësive për përdorimin e tokës në aktivitete ekonomike, siç janë bujqësia, industria, turizmi dhe shërbimet, me qëllim rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës.
- **Përdorimi bujqësor:** Identifikimin e tokave më të përshtatshme për aktivitete bujqësore dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e prodhimit dhe menaxhimin e tokës bujqësore.
- **Analiza demografike dhe sociale:** Marrja në konsideratë e ndryshimeve demografike dhe sociale për të mundësuar një planifikim më të efektshëm të përdorimit të tokës, duke siguruar që nevojat e popullatës lokale të merren parasysh.
- **Përputhja me legjislacionin:** Sigurimi që propozimet dhe strategjitë për përdorimin e tokës të jenë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret kombëtare dhe lokale.

Ky hulumtim i masterit trajton pyetje kërkimore dhe hipoteza të lidhura me temën "Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit". Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat janë si vijon:

- **Cili është përdorimi aktual i tokës në komunën e Gjilanit?**
Kjo pyetje ka për qëllim të analizojë ndarjen dhe përdorimin aktual të tokës në komunën e Gjilanit, duke përfshirë sektorët e bujqësisë, ndërtimit, hapësirave të gjelbra dhe zonave industriale.
- **Cilat janë sfidat kryesore në menaxhimin e tokës dhe si mund të adresohen ato për një zhvillim të qëndrueshëm?**
Kjo pyetje synon identifikimin e problemeve kryesore që lidhen me përdorimin e tokës dhe ofrimin e zgjidhjeve për përmirësimin e menaxhimit të tokës në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

Hipoteza:

- Përmirësimi i planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës do të kontribuojë në një zhvillim më të qëndrueshëm dhe efikas në komunën e Gjilanit.
- Kjo hipotezë mbështet idenë se politikat dhe strategjitë e planifikimit të qëndrueshëm mund të sjellin përmirësime të ndjeshme në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Gjatë këtij studimi, është dizajnuar një qasje gjithëpërfshirëse për të vlerësuar dhe analizuar përdorimin e tokës në komunën e Gjilanit, duke përdorur një kombinim të avancuar të teknikave gjeografike, teknologjive të Sistemit Informativ Gjeografik (GIS), Remote Sensing dhe analizave të planifikimit hapësinor. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të ofrohen rekomandime të bazuara në të dhëna shkencore për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm dhe menaxhimin efikas të burimeve tokësore.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është e strukturuar në disa faza të rëndësishme, si më poshtë:

1. Grumbullimi i të dhënave:

- **Të dhënat gjeografike:** Mbledhja e të dhënave bazë gjeografike për komunën e Gjilanit, përfshirë informacionin mbi topografinë, hidrografinë, përdorimin aktual të tokës dhe aspektet klimatike të rajonit.
- **Të dhënat GIS:** Grumbullimi i të dhënave nga burime të ndryshme, përfshirë bazat e të dhënave GIS të disponueshme nga agjencitë qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat ofrojnë informacion të detajuar mbi përdorimin e tokës dhe aspektet e tjera

gjeografike.

- **Remote Sensing:** Analiza e imazheve satelitore për të identifikuar ndryshimet në përdorimin e tokës dhe mbulueshmërinë e saj, duke krijuar indekse gjeografike që mundësojnë kuantifikimin e këtyre ndryshimeve, siç janë NDVI (Vegetation Index), NDBI (Built-up Index), etj.

2. Përpunimi dhe Analiza e të Dhënave:

- **GIS:** Përdorimi i softuerëve të specializuar GIS për integrimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura, duke krijuar harta të detajuara që paraqesin përdorimin aktual të tokës dhe zonat me potencial për zhvillim.
- **Analiza gjeografike:** Studimi i karakteristikave fizike dhe socio-ekonomike të komunës, për të identifikuar zonat me potencial të lartë për përdorime të ndryshme të tokës dhe për të vlerësuar mundësitë dhe kufizimet që lidhen me këto përdorime.
- **Planifikimi hapësinor i qëndrueshëm:** Zhvillimi i skenarëve të mundshëm për përdorimin e ardhshëm të tokës, duke u mbështetur në rezultatet e analizave GIS dhe Remote Sensing. Ky proces merr parasysh nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social, si dhe ruajtjen e resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Qëllimi i këtij studimi ishte analiza dhe vlerësimi i potencialit të përdorimit të tokës në komunën e Gjilanit për një planifikim hapësinor të qëndrueshëm, duke marrë parasysh dimensionet fiziko-gjeografike, socio-ekonomike dhe ligjore.

Studimi kishte si objektiv shqyrtimin e mbulueshmërisë aktuale të tokës, identifikimin e sfidave lidhur me përdorimin e saj, si dhe propozon strategji të bazuara në teknologjitë moderne, përfshirë GIS dhe Remote Sensing, për menaxhimin efikas të saj.

Rezultatet e analizës tregojnë se përdorimi i tokës në komunën e Gjilanit ka pësuar ndryshime të theksuara në dekadat e fundit, kryesisht si pasojë e procesit të urbanizimit dhe zgjerimit të zonave të ndërtuara. Analiza e të dhënave të mbledhura nga CORINE Land Cover (CLC) dhe ESRI Land Use/Land Cover (LU/LC) ka treguar se sipërfaqet urbane janë zgjeruar në kurriz të tokave bujqësore dhe zonave natyrore, duke theksuar domosdoshmërinë e një planifikimi hapësinor të mirë strukturuar dhe të integruar.

Një faktor kyç në këtë transformim janë ndikimet e ndryshme biofizike dhe shoqërore, përfshirë klimën, topografinë, infrastrukturën dhe politikën urbane, të cilat kanë kontribuar në ndryshimet e përdorimit të tokës. Literatura ekzistuese dhe analiza hyrëse nënvizojnë rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës si element të domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rural. Në këtë kontekst, planifikimi hapësinor në komunën e Gjilanit duhet të synojë një balancim të kujdesshëm mes zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit natyror, duke ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare dhe direktivat evropiane si INSPIRE.

Përputhja me legjislacionin vendor dhe strategjitë për parandalimin e degradimit të tokës janë aspekte të rëndësishme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të harmonizuar. Rezultatet e studimit konfirmojnë hipotezën e ngritur, që sugjeronte se një përmirësim i planifikimit urban dhe menaxhimit të përdorimit të tokës do të kontribuonte në zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikas të komunës së Gjilanit.

Në këtë kuadër, analiza e të dhënave gjeohapësinore ka zbuluar se urbanizimi i shpejtë dhe ndryshimet në përdorimin e tokës kanë pasur ndikime të theksuara në mbulueshmërinë dhe funksionalitetin e zonave të ndryshme. Sfidat kryesore lidhen me përhapjen e ndërtimit të pakontrolluar, tkurrjen e hapësirave të gjelbra dhe menaxhimin joefikas të burimeve natyrore.

Për një zhvillim të qëndrueshëm, studimi rekomandon forcimin e politikave urbane, zbatimin më rigoroz të legjislacionit për planifikimin hapësinor, si dhe përdorimin e avancuar të teknologjive

gjeohapësinore për monitorimin dhe menaxhimin e përdorimit të tokës. Integrimi i sistemeve GIS dhe Remote Sensing është i domosdoshëm për vlerësimin e potencialit të përdorimit të tokës dhe për siguruar një qasje të balancuar midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Ky studim ofron një qasje të avancuar, të bazuar në të dhëna, për të mbështetur vendimmarrjen në planifikimin hapësinor të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit.

KONKLUZIONI DHE PROPOZIMI

Kjo teme e masterit thekson rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës në komunën e Gjilanit, duke ofruar një pasqyrë të gjendjes aktuale dhe mundësive për zhvillim të ardhshëm. Analiza ka treguar se ndryshimet në mbulueshmërinë e tokës ndikohen nga faktorë natyrorë dhe njerëzorë, me urbanizimin si një sfidë kryesore që kërkon një qasje më të avancuar në planifikimin hapësinor. Studimi konfirmon rolin kyç të mjeteve moderne të analizës gjeohapësinore si GIS dhe Remote Sensing në monitorimin dhe menaxhimin efektiv të ndryshimeve hapësinore, duke siguruar një bazë të fortë për vendimmarrjen informuar. Rezultatet konfirmojnë hipotezën e ngritur, duke dëshmuar se përmirësimi i politikave dhe strategjive të planifikimit të tokës mund të kontribuojë në zhvillimin më të qëndrueshëm të komunës. Ky hulumtim ofron një kontribut të vlefshëm shkencor në fushën e planifikimit hapësinor, duke kombinuar analizën teorike me të dhëna konkrete të marra nga teknologjitë gjeohapësinore, që ndihmojnë në thellimin e kuptimit mbi proceset që ndikojnë në ndryshimet e përdorimit të tokës. Megjithatë, studimi ka disa kufizime, përfshirë varësinë nga të dhënat satelitore dhe burimet ekzistuese të informacionit, të cilat mund të mos pasqyrojnë të gjitha detajet e terrenit. Po ashtu, faktorët socio-ekonomikë dhe ndikimi i politikave lokale nuk janë trajtuar në thellësi, duke lënë hapësirë për studime të mëtejshme që mund të përqendrohen në këto aspekte. Pavarësisht këtyre kufizimeve, ky studim ofron një bazë të fortë për kërkime të ardhshme dhe nxit diskutime mbi rëndësinë e planifikimit të qëndrueshëm të tokës në nivel lokal dhe më gjerë.

Në përfundim të vlerësimit të dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit **Edon SHEMSEDINI**, me titull "**Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit (Land use potential for sustainable planning in the municipality of Gjilan)**", mund të nxirren këto konkluzione kryesore:

- **Tematika e përzgjedhur** për këtë tezë është origjinale dhe i kushtohet një analize të thelluar të një hapësire dhe periudhe kohore që është relativisht pak e trajtuar në literaturën gjeografike dhe atë të planifikimit hapësinor. Ky studim paraqet një kontribut të vlefshëm në fushën e studimit të organizimit hapësinor dhe funksional të potencialit të përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm, duke trajtuar një zonë të caktuar, të rëndësishme për zhvillimin urban në komunën e Gjilanit dhe në gjithë Kosovën.
- **Përdorimi i të dhënave dhe metodologjisë** është në përputhje me standardet shkencore, duke siguruar një analizë të detajuar të zhvillimeve hapësinore dhe funksionale përgjatë periudhës kohore të shqyrtuar. Të dhënat e grumbulluara dhe të analizuar, si dhe format e ndryshme grafike të përpiluara për këtë hapësirë, kanë vlerë të lartë shkencore dhe janë gjithashtu të dobishme për praktikën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj komune. Ato ofrojnë një bazë të fortë për planifikimin e qëndrueshëm në komunën e Gjilanit, si dhe për krijimin e strategjive të planifikimit të qëndrueshëm.


Mbështetur në vlerësimet dhe konkluzionet e mësipërme, Komisioni profesional ka vlerësuar se

punimi i masterit të kandidatit **Edon SHEMSEDINI**, me titull **''Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të qëndrueshëm në komunën e Gjilanit (Land use potential for sustainable planning in the municipality of Gjilan)''**i plotëson të gjitha kërkesat formale, juridike dhe shkencore-profesionale për të kaluar në procedurat e mëtutjeshme të shqyrtimit dhe miratimit të kësaj teze. Ky punim është një kontribut i rëndësishëm në fushën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe është një shembull i shkëlqyer i përdorimit të metodologjive moderne për studimin e hapësirave urbane dhe rurale.


Prishtinë, 06.03.2025

Komisioni:


1. Prof. Dr. Arsim EJUPI- kryetar



2. Prof. Asoc. Ferim GASHI - anëtar



3. Prof. Asoc. Ibrahim RAMADANI- anëtar



P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.